



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

PA1.nr.1024/2021

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** - Departamenti i përgjithshëm, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Zyhdi Haziri, anëtarë, me sekretaren juridike, Fitnete Hoti, procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit E.M., nga fshati Dobratin, komuna e Podujevës, për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 349 par. 2 të KPK, duke vendosur sipas ankesës së të akuzuarit E.M., të ushtruar nëpërmes av. Rexhep Fusha, e ushtruar kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.108/2021, të datës 21.06.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 15.11.2021 mori këtë:

### A K T G J Y K I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e të akuzuarit E.M., e ushtruar nëpërmes av. Rexhep Fusha, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.108/2021, të datës 21.06.2021, **vërtetohet**.

### A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.108/2021, të datës 21.06.2021, është shpallur fajtor i akuzuari E.M., për shkak të veprës penale vjedhje pylli nga neni 349 par. 2 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumën prej 300 Euro, të cilin dënim i akuzuari është obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjyqimit, si dhe dënimi me kusht, duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet po që se i akuzuari në afatin e verifikimit prej 1 viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Nëse i akuzuari dënimin e shqiptuar me gjobë nuk e paguan në afatin e përcaktuar, i njëjti do ti zëvendësohet në dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 15 ditëve, duke i llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg me nga 20 Euro.

Është obliguar i akuzuari që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 50 Euro, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 30 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjyqimit.

I dëmtuari, Rr.R., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontestin e rregullt juridiko-civil.

Në kuptim të nenit 59 par. 1 dhe 2 nën par. 2.2 të KPK, të akuzuarit i është shqiptuar dënimi plotësues Urdhri për Kompensimin e Humbjes apo Dëmit, ashtu që është urdhëruar i akuzuari që të dëmtuarit Rr.R., t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar në shumën prej 946.62 Euro, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesë ka ushtruar, i akuzuarit E.M., nëpërmes av. Rexhep Fusha, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe i akuzuari të lirohet nga akuza, apo që i njëjti të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Prokuroria e Apelit në Prishtinë, me parashtresën PPA/II.nr.1040/2021, të datës 11.08.2021, duke u sqaruar përkitazi me ankesën e ushtruar, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe shkresat e tjera të lëndës, ka propozuar që ankesa e të akuzuarit E.M., e ushtruar nëpërmes av. Rexhep Fusha, të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenit 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesa e ushtruar, aktgjykimin e ankimuar, shkresat e tjera të lëndës, si dhe propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, ka gjetur se:

**Ankesa e të akuzuarit E.M., e ushtruar nëpërmes av. Rexhep Fusha, nuk është e bazuar.**

Sipas ankesës së ushtruar, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, duke theksuar se dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është kontradiktor për faktin se në pikën V të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, i dëmtuari është udhëzuar në kontestin e rregullt juridiko-civil, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, ndërsa më pas duke u bazuar në dispozitën e nenit 59 par. 1 dhe 2 nën par. 2.2 të KPK, të akuzuarit i është shqiptuar dënimi plotësues, urdhri për kompensimin e humbjes apo dëmit dhe e urdhëron e akuzuarin që të dëmtuarit ti kompensoj dëmin e shkaktuar në shumën prej 946.62 Euro, kjo është bërë në kundërshtim me dispozitat e KPK. Po ashtu, është caktuar kompensimi pa u bërë ekspertiza nga eksperti i lëmisë përkatëse dhe pa u bërë shikimi i vendit të ngjarjes nga ana e gjykatës me ekspert – gjeodet për të vërtetuar vendin se ku janë prerë drunjt, diametrin dhe e kujt është prona, a është pronë private apo shoqërore, pra kjo është vendosur në mënyrë paushallë pa prova dhe fakte të mjaftuara. Dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i paqartë dhe i pa kuptueshëm e kontradiktor me arsyet e aktgjykimit dhe i njëjti në masë të konsiderueshme është kontradiktor mes asaj çka paraqitet në aktgjykim dhe arsyet e tij, me përmbajtjen e fakteve dhe provave të vërtetuara në shqyrtim kryesor. Nga i njëjti, nuk mund të kuptohet se a është vërtetë i akuzuari kryerës i kësaj veprë penale dhe për këtë fakt me rëndësi nuk janë paraqitur arsye të mjaftueshme dhe ato të paraqitura janë në kundërshtim me provat e vërtetuara. Kështu nga dispozitivi i aktgjykimit rezulton se gjykata të akuzuarin e ka gjykuar me dënim me gjobë dhe dënim me kusht. Dispozitivi i aktgjykimit është në tërësi në kundërshtim me arsyet e aktgjykimit dhe në masë të konsiderueshme është kontradiktor për faktin se në dispozitivin e aktgjykimit përveç tjerash thuhet, se i akuzuari pa leje përkatëse e me qëllim të vjedhjes me sharrë motorrike

ka prerë dhe dëmtuar në mënyrë të ndryshme 26 copë trungje të llojit Ahu, të gjatë 7-15 metra, me diametër 22-27 cm, me vëllim 6.80 m<sup>3</sup>, në vlerë 946.62 Euro, i cili është zënë nga roja e pyllit në vendin e ngjarjes. Ndërsa nga dëshmia e dëshmitarit B.J., në cilësi të rojës së pyllit, i cili ka deklaruar se të akuzuarin natën kritike nuk e kishte parë e as ndonjë herë më parë, ndërsa nuk është në dijeni se në pronësi të kujt ka qenë prona, ku janë prerë durnjt ngase nuk ka poseduar një dokumentacion të tillë, e as të ketë qenë në dijeni se sa drunjë ishin prerë. Nga dëshmia e rojës së pyllit është vërtetuar se ajo që është theksuar në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, nuk është e vërtetë. Gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin është bazuar vetëm në deklaratat e të dëmtuarit, duke mos i marrë parasysh deklaratat e rojës së pyllit, i cili në mënyrë të qartë ka deklaruar se nuk e ka parë të akuzuarin as natën kritike e as ndonjë herë tjetër. Me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë, kurse gjykata e shkallës së parë vendimin e ka marrë duke u bazuar në supozime, e që nuk është e drejtë, pasi që nuk duhet të dënohet askush duke u bazuar vetëm në supozime.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, e ka vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, sipas ankesës së ushtruar, përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 i KPPK, për të cilat shkelje ky kolegji përkujdeset edhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 394 të KPPK, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përfshihet me shkeljet e pretenduara, pasi që dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë, i kuptueshëm dhe në harmoni me vetveten si dhe pjesët tjera të aktgjykimit, se në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, janë paraqitur arsyet përkitazi me faktet vendimtare të cilat e karakterizojnë veprën penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit, andaj kolegji i kësaj gjykate ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë në arsyetim ka paraqitur arsyet për çdo pikë të aktgjykimit. Se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë përmban formën e paraparë me shkrim, në kuptim të nenit 370 të KPPK, rezulton pas vlerësimit të aktgjykimit të ankimuar, pasi që i njëjti përmban të gjitha pjesët që duhet ti përmbaj aktgjykimi, se në arsyetim të aktgjykimit janë paraqitur arsyet përkitazi me çdo pikë të njëjtit, se në arsyetim të aktgjykimit janë paraqitur qartë dhe në mënyrë të plotë dhe të saktë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i ka konsideruar si të vërtetuara apo të pa vërtetuara, e gjithashtu është paraqitur saktësia e secilës provë të ngritur, e cila ka qenë e nevojshme për të vendosur çështjen penale, andaj aktgjykimi si i tillë është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Sipas ankesës së ushtruar, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të shkeljes së ligjit penal, duke theksuar se shkelja e ligjit penal në dëm të akuzuarit vjen si rezultat i shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. I akuzuari në tërësi e ka mohuar veprën penale e cila i vihet në barrë dhe nuk e ndien veten fajtor, sepse nuk është kryerës i kësaj vepre penale, dhe se me asnjë provë materiale nuk është vërtetuar se i akuzuari e ka kryer këtë vepër penale, por aktgjykimi i ankimuar nuk është mbështetur në prova, por vetëm në supozime dhe pikërisht për këto arsye aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është i mangët dhe i paqëndrueshëm.

Kolegji i kësaj gjykate, ka vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, sipas ankesës së ushtruar, përkitazi me shkeljet e ligjit penal nga neni 385 i KPPK, për të cilat shkelje përkujdeset edhe sipas detyrës zyrtare, në kuptim të nenit 394 të KPPK, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet e pretenduara, pasi që vepra e cila i vihet në barrë të akuzuarit, përbën vepër penale të dënueshme sipas dispozitave të KPK, se nuk kanë ekzistuar rrethana që përjashtojnë të akuzuarin nga ndjekja penale, e po ashtu nuk kanë ekzistuar as rrethana që përjashtojnë të akuzuarin nga përgjegjësia penale, se në këtë çështje penale është aplikuar ligji i cili ka qenë i aplikueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale, si dhe gjykata e shkallës së parë

ka vepruar në kuadër të kompetencave ligjore për çka aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk përfshihet me shkeljet e pretenduara.

Sipas ankesës së ushtruar, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar edhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke theksuar se aktgjykimi i ankimuar nuk është i mbështetur në prova, por në supozime dhe indicie. Arsyet e paraqitura lidhur me faktet vendimtare, përkritazi me vërtetimin e gjendjes faktike janë konfuze dhe të paqëndrueshme, e në kundërshtim direkt me gjendjen faktike të vërtetuar në seancën kryesore. Kështu së pari nuk është vërtetuar me asnjë provë se i akuzuari e ka kryer veprën penale. për këtë arsye krejt kjo gjendje faktike e bën aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë të paqartë dhe të pa vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, andaj aktgjykimi i ankimuar duhet ndryshuar dhe i akuzuari të lirohet nga akuza, apo që i njëjti të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Kolegji i kësaj gjykate, e ka vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, ankesën e ushtruar, dhe ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila gjendje vërtetohet nga provat e administruara në shkresat e lëndës. Për gjykatën e shkallës së parë nuk ishte kontestues fakti se te xhamia e fshatit Dobratin të Podujevës, policia e ka ndaluar të akuzuarin dhe nga i njëjti kanë konfiskuar drunjë, për shkak se nuk ka poseduar leje për prerjen e drunjëve, e që sipas të akuzuarit kjo kishte ndodhur dy ditë pas ditës kritike. Nga deklarata e të dëmtuarit, RR.R., të dhënë në cilësi të dëshmitarit, është vërtetuar fakti se natën kritike më dt. 24.08.2020, në pyllin e tij, nga një distancë afërsisht 3 metra, kishte parë të akuzuarin E.M. i shoqëruar nga disa persona tjerë duke prerë drunjë, mirëpo të njëjtit kanë ikur nga vendi i ngjarjes posa kanë vërejtur dritat e automjetit të policisë, të cilës deklaratë gjykata e shkallës së parë me të drejtë i ka falur besimin, pasi që e njëjta gjen mbështetje edhe në provat tjera të administruara gatë shqyrtimit gjyqësor. Nga deklarata e dëshmitarit F.R., është vërtetuar fakti se natën kritike më dt. 24.08.2020, në pyllin i cili është pronë e përbashkët e familjes së tyre, derisa së bashku me babin, axhën dhe disa të afërm të tij ishin duke vëzhguar, ka parë të akuzuarin me 5-6 persona tjerë duke prerë drunjë me motor sharrë në pyllin, pronë e të dëmtuarit, mirëpo të njëjtit kanë ikur nga vendi i ngjarjes posa kanë vërejtur dritat e automjetit të policisë, e cila deklaratë është në përputhje me deklaratën e të dëmtuarit dhe me provat tjera të administruara. Nga foto albumi i vendit të ngjarjes në mënyrë të pakontestueshme vërtetohet fakti se drunjtë e konfiskuara të akuzuarit nga Policia e Kosovës, pas krahasimit të mostrave drusore, rezulton se mostrat drusore të konfiskuara nga i akuzuari, në bazë të karakteristikave, veçorive, formave dhe diametrit të tyre, korrespondojnë plotësisht me cungjet e prera në vendin e ngjarjes, andaj kjo ka paraqitur bazë të sigurt për të argumentuar lidhjen kauzale mes veprimeve të akuzuarit dhe pasojës së shkaktuar. Nga certifikata e pronësisë me nr. 08/942/06-42995 e t. 26.05.2020, vërtetohet se RR.R. është pronar i paluajtshmërive zona kadastrale Dobratin të disa njësive kadastrale, ku është prerë pylli nga i akuzuari. Duke pasur parasysh të gjitha ato që u thanë më lartë si dhe provat tjerë të cilat gjenden në shkresat e lëndës, kolegji i kësaj gjykate ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike në këtë çështje penale, ashtu që drejtë ka vendosur kur të akuzuarin e ka shpallur fajtor për veprën penale e cila i vihet në barrë.

Sipas ankesës së ushtruar, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë është ankimuar për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, mirëpo i njëjti nuk ka dhënë asnjë arsye përkritazi me këtë bazë ankimore.

Kolegji i kësaj gjykate, e ka vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, ankesën e ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljet e ligjit penal, se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila është vërtetuar nga provat e administruara në shkresat e lëndës, ashtu që gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit për dënimin, caktimit të llojit dhe lartësisë së tij, ka vlerësuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 të KPK, dhe rrethana lehtësuese ka vlerësuar gjendjen e varfër ekonomike të akuzuarit, kurse si rrethana rënduese ka vlerësuar faktin se i akuzuari ka qenë i dënuar më parë për vepra të njëjta penale me vendime të formës së prerë, sikurse janë, aktgjykimi P.nr. 668/18 i plotfuqishëm më dt. 15.01.2019, i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumën prej 130 Euro, për shkak të veprës penale vjedhje e pyllit nga neni 358 i KPK, P.nr. 326/18 dënim me gjobë në shumë prej 120 Euro, për shkak të veprës penale kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose i vijës kufitare nga neni 146 i KPK, P.nr. 1054/17, i plotfuqishëm më dt. 19.02.2018, i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumën prej 120 Euro, për shkak të veprës penale vjedhje e pyllit nga neni 358 i KPK, P.nr. 1013/17 i plotfuqishëm më dt. 18.12.2017, dënim me gjobë në shumën prej 150 Euro, për shkak të veprës penale vjedhje e pyllit nga neni 358 të KPK, P.nr. 269/17, i plotfuqishëm më dt. 26.07.2017, dënimi me gjobë në shumën prej 200 Euro, për shkak të veprës penale vjedhje e pyllit nga neni 358 i KPK, P.nr. 1091/15 i plotfuqishëm më dt. 26.08.2016, dënimi me kusht për veprën penale vjedhje e pyllit nga neni 358 i KPK dhe P.nr. 592/15, dënimi me kusht për shkak të veprës penale vjedhje e pyllit nga neni 358 i KPK, mënyrën e kryerjes së veprës penale, si dhe shkallën e intensitetit të kryerjes së të njëjtës. Nga ankesa e ushtruar, nuk ka gjetur ndonjë rrethanë posaçërisht lehtësuese, andaj, në prani të këtyre rrethanave, kolegji është i bindur se me dënimin e shqiptuar do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij, që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të paraparë në nenin 38 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPPK, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**PA1.nr.1024/2021, të datës 15.11.2021**

**Sekretarja juridike,**  
**Fitnete Hoti**

**Anëtarët e kolegjit**  
**Hashim Çollaku**

**Kryetari i kolegjit**  
**Ferit Osmani**

**Zyhdi Haziri**